



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



02/ Nr.

7287

Data: 04.09.2025

**PROCESVERBAL I DËGJIMIT BUXHETOR I DEDIKUAR PËR BANORËT E LAGJES
SË RE LIDHUR ME DRAFT BUXHETIN E VITIT 2026 DHE PARASHIKIMET PËR
VITET 2027-2028**

Procesverbali nga Dëgjimi i dhjetë Buxhetor në lidhje me Draft Buxhetin e Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2026 dhe parashikimi për vitet 2027-2028, të mbajtur me datën **15.08.2025**, duke filluar nga ora **19:00** tek **Oda e Pritjes në Lagje të Re**, me gjithsej 20 pjesëmarrës/e, prej tyre 2 gra dhe 18 burra. Nga ekzekutivi, të pranishëm ishin Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, **z.Mehmet Ballazhi**, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, **znj.Lindita Ballazhi**, si dhe nga Zyra e Kryetarit.

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës **z.Mehmet Ballazhi**, i cili iu uroi mirëseardhje të pranishmëve, të cilët kishin gjetur kohë për të ardhur në dëgjimin buxhetor për prezentimin e draft buxhetit të Komunës Hanit të Elezit për vitin 2026, si dhe parashikimi për vitet 2027-2028, ku për rend të punës, kishte:

1. **Prezentimi i draft buxhetit të Komunës Hani i Elezit për vitin 2026 dhe parashikimi për vitet 2027-2028**
2. **Diskutimi**

Mehmet Ballazhi: Jemi në dëgjimin e radhës lidhur me draft buxhetin e vitit 2026 dhe parashikimet për vitet 2027-2028, dhe këtë herë për herë të parë mbajmë debat me banorët e Lagjes së Re, një komunitet mjaft i madh, ku para këtij kemi mbajtur dëgjime në fshatra, me fermerët, me gratë, me sektorine arsimit dhe shëndetësisë, sepse e kemi mendu se kështu mund të bashkohet më mirë pjesëmarrja në vendimmarrje më gjithëpërfshirëse. Atëherë, këto dëgjime që po realizohen janë pas pranimi të Qarkores së dytë buxhetore, ku për Qarkoren e parë i kemi mbajtur dëgjimet në qershor për KAB-in, ndërsa tani po reazlojmë dëgjimet për draftin final të buxhetit, e ku shpresoj se shumë nga ju do të kontribuojnë duke propozuar, paraqitur kërkesa, rekomandime, etj. Ky buxhet për vitin 2026 përfshin diku 4.2 milion euro dhe përfshin disa kategori buxhetore, ku pjesa më e madhe e buxhetit është për pagat e të gjithë punëtorëve civil , ku janë diku rreth 250, duke përfshirë administratën komunale, stafin arsimor e shëndetësor apo rreth 62% e buxhetit, investime kapitale janë rreth 868 mijë euro, e poashtu edhe subvencionet, shërbime komunale etj. Pra, në total 4.2 milion euro. Qëllimi i dëgjimeve është që sipas kërkesave apo rekomandimet e pjesëmarrësve me u orientu buxheti komunal. Për ma shumë detaje me shifra, besoj drejtoresha do ta prezantojë buxhetin komunal për vitin 2026.

1. Prezentimi i draft buxhetit të Komunës Hani i Elezit për vitin 2026 dhe parashikimi për vitet 2027-2028

(Drejtoresha Lindita Ballazhi përshëndet dhe falënderon të pranishmit për pjesëmarrje në dëgjim buxhetor të dedikuar për sektorin e arsimit dhe shëndetësisë.)

Lindita Ballazhi: Planifikimi fillestar i buxhetit ka qenë që nga muaji qershor, ku na janë përcjellë kufijtë fillestarë buxhetor dhe se sa staf do të kemi për vitin vijues, si dhe parashikimet e hershme për vitet 2027-2028. Tash jemi në fazën finale të planifikimit të buxhetit, ku më 1 hstator do ta dorëzojmë buxhetin në Kuvend Komunal dhe buxheti duhet të miratohet nga Kuvendi Komunal deri më 30 shtator si datë e fundit. Buxheti për vitin 2026 do të jetë në shumë prej 4,234,682 €, dhe në bazë të kalkulimeve që i kemi bërë 2.4 milion shkon në kategorinë e pagave dhe pjesa tjetër duhet të mbulohen kategoritë e tjera si shpenzime komunale, siç janë të sektorit të arsimit të shëndetësisë, që janë të obligueshme për çdo muaj, të administratës komunale dhe të zjarrëfikësve. Ajo çka ja vlen të theksohet për vitin 2026 kemi rritje të buxhetit, e poashtu kemi rritje te kategoria Investime Kapitale, por edhe te kategoria e Subvencioneve. Risi tjetër e buxhetit të planifikuar është se i kemi 13 pozita të reja të aprovuara në sektorin e shëndetësisë, ku katër prej tyre janë të përcaktuara: fizioterapeut, logoped, psikolog dhe punëtor social. Në fletushkat të cilat i keni përpara janë disa projekte kapitale të cilat janë të miratuara në qershor nga Kuvendi Komunal. Ky është dëgjimi i fundit buxhetor për këtë fazë dhe ne do të mbajmë shënime për çdo kërkesë, propozim, apo rekomandim, dhe do të dërgohen në Kuvend Komunal, e ku më pas Kuvendi Komunal do të bëjë miratimin e buxhetit.

2. Diskutimi

Mehmet Ballazhi: Pas prezantimit nga drejtoresha, unë e hap diskutimin për të pranishmit. Nëse keni ndonjë sugjerim, rekomandim apo kërkesë për buxhetin e vitit 2026.

Arafat Luri: Një kërkesë që edhe ma herët e kemi parashtrur në komunë, edhe para shumë vjetësh edhe vazhdimisht masanej, është me i ndrru shtyllat elektrike, se ato që janë për momentin janë shumë të vjetra, prej nashta viteve 1979, ku 5-6 shpi jemi të lidhur me këto shtylla, kemi pas probleme ku vitin e kalim janë rrxu e kemi pas ndërërje të rrymës disa ditë. Kërkesa ime është se qysh me vepru që na me pas rrjet të ri elektrik ose me u ndrru shtyllat sepse janë të rrezikshme.

Mehmet Ballazhi: Çështjet që ndërlidhen me rrjet elektrik, shtylla ose rrjet i ri nuk hyjnë në komoetenca tona komunale, por ajo që ne mundemi me bo është nëse ju si banorë e parashtroni kërkesën në komunë, e mandej ne qat kërkesën tuaj me e adresu në KEDS.

Nehat Xhoni: Unë propozoj që me u fut në buxhet edhe rregullimi i kanalizimit te rr.”7 MArsi” apo rruga që çon te xhamia, ky kanalizimi që është momentalisht është bërë kah vitet e 90’ta nga vet banorët me mjete vetanake, gjatësia diku është rreth 300 metra, nuk ka asnjë shakt, dhe gypat momental i ka të hollë të sallonitit. Dhe para se me u bo ndonjë bllokim ose problem me dal aty, duhet urgjentisht me u intervenu.

Mehmet Ballazhi: Ne veçse e kemi në buxhet rregullimin e kanalizimeve , vetëm tash ne e marrim si propozim rr."7 Marsi" pr em intervenu pak ma urgent shkak i vjetërsisë.

Nehat Berisha: Ne e diskutojmë shpesh si mahallë, lidhur me veturat që po lëvizin me shpejtësi, dhe besoj se për me i parandalu ndonjë aksident a diçka, se ne kemi fëmijët por edhe pleqtë për në xhami, por edhe vet që kalojmë në këto rrugë, duhen me u vendos ndërpresa apo pengesa në rrugë, sidomos në pjesë ku edhe shoferët po ecin ma shpejt.

Sadat Hasallari: Përveç pengesave në rrugë, besoj se duhet me u vendos edhe një pasqyre e rrugës te trafo aty, se shpesh nuk shihet rruga kur kthen aty edhe shumë lehtë mundet mu shkaktu aksident.

Mehmet Ballazhi: Edhe për këtë kërkesë do të ishte mirë që si lagje me e bo kërkesën dhe besoj se kjo kryhet pa e prit vitin e ardhshëm, nëpërmjet shërbimeve publike, pra edhe pasqyra rrugore por edhe pengesat në rrugë, sidomos për pengesat në rrugë dueht të jeni dakord të gjithë se kemi pas rast që e kemi evndos diku shkak i ankesave për vetura të shpejta dhe ka dal ka kundërshtu tjetri tu thanë që pse me e vendos para shpis ose që nuk iu ka përshatat.

Xhemil Ballazhi: Te rruga te shpia jeme, rr."Veteranët e UÇK-së", po vijnë vetura nga Tetova me shpejtësi pak tepër të madhe, e aty besoj s epengesa në rrugë nuk lejohet, po s'paku kufizim i shpejtësisë ose kthese e rrezikshme, sepse shpesh po rrezikohen banorët, por edhe veturat që munden me u ndesh.. Gjithastu te kthesa prej lokalit deri kah shpia e Tahirit aty kah rruga që shkon për Gorancë ka mbetë ka mbetë qajo hapësirë shumë keq, i ka humb ajo bukuria e me mujt me e rregullu pak me kubëza ose diçka se aty veç therrra dalin.

Mehmet Ballazhi: Mundemi me pa mundësinë edhe me mbjell diçka në atë pjesë, por edhe e shohim mundësinë tjetër që e propozut tek kjo pjesë apo hapësirë.

Vebi Bajramaliu: Kam një propozim, nëse është mundësia, që te kjo kthesa që dalim në rrugë para shitores aty, afër pllacit, e me kshyr mundësinë ajo kthesa aty me u merr pak , me u rregullu ai muri ma në hark që me u bo rruga ma e pashme, me pa dmth rrugën ma mirë kalohet se për moment si është kur jemi me veturë duhet me dal deri në gjys gati në rrugë për me pa a ka apo jo vetura tjera e kjo po bohet e rrezikshme shumë shpesh se nuk shihet rruga hic, e ka vetura që vijnë nga ana e kundërt. E me mujt me bisedu me pronarin me e lëshu pak hapësirë që aty kthesa me u bo hark ma shumë sa me pas mundësi me u pa rruga kur merret ajo kthesë, ndoshta i merr 2-3 metra katror.

Mehmet Ballazhi: Ne e marrim si propozim, por duhet shqyrtu mundësia.

Sadik Rexhallari: Kam një kërkesë lidhur me punimet që po bëhen tek e shemta , pra rruga që çon në Gorancë dhe kompania që po punon nuk di se çfarë obligimesh ka. Prej aty kanë fillu me ra gurë e dheu, dhe nëse ka vërshime ose diçka të tillë, ne si lagje rrezikohemi që ato gurë me ardh deri në shpi tonat. Kisha propozu që me u formu një komision dhe me dal në terren me u vëzhgu situata, me u hulumtu mbi rreziqet edhe përmes kësaj me u evitu rreziqet që munden me ardh në Lagje nga këto gurë që çdo ditë po ka rrezik. Mendoj se kjo është çështja ma prioritet.

Mehmet Ballazhi: Ky projekt është prej Ministrisë dhe kompania e ka obligim me e mirëmbajtë dhe Ministria e miraton. NE në bisedimet tona me punëkryesin dhe Ministrinë na kanë thanë që pas kryerjes së punimeve, vet kompania do ta zgjidhë këtë problem, tash a duke vendos rrjeta a pengesa do të mbetet si obligim i kompaninë në monitorimin e Ministrisë.

Visar Hasallari: Fillimisht është me u përshëndet që për herë të parë po organizohet dëgjim buxhetor në Lagjen e Re, ku përfshin një numër majft të madh të banorëve, por edhe hapësirë. Unë kam disa kërkesa dhe porpozime:

- një sqarim nga ana e juaj rreth shkollës në Lagje të Re, se ku ka mbetë si proces dhe çfarë do të ketë në këtë drejtim vitin e ardhshëm;
- një kërkesë që mendoj se është edhe ky projekt me prioritet, është pastrimi i përroit nëntokësor, s eka 3 vjet që nuk është pastru;
- vendosja e pengesave kah rruga te fabrika e suxhukut dhe brenda në Lagje;
- te pjesa përballë lokalit të Hajdinit, aty shumë mirë që është investu, është bërë parking, por ka mbetë edhe një hapësirë aty afër që pse jo me vendos lodra për fëmijë e me u shfrytëzu edhe ajo pjesë;
- lidhur me çështje të sigurisë, besoj me e diskutu edhe në KKSB, ku te xhamia në Lagje të RE po frekuentohet nga sirianë ku vijnë kah 15-16 persona, ku shpesh po i hasim sidomos netëve, deri tash nuk kemi pas probleme me ta, por me kontaktu policinë ose akterë tjerë që me pas ma shumë siguri;
- qysh është mundësia në veçanti për rininë që me u mbështetë nga komuna, me i rrit subvencionet, me u përkrah bizneset e reja inovative, apo se çka keni paraparë për vitin e ardhshëm.

Mehmet Ballazhi: Po iu përgjigjem me radhë:

- te çështja e shkollës, deri tani janë grumbullu 200 mijë euro, dhe ka mebtë edhe një pjesë, pra aty edhe do të ndërtohet shkolla, çerdhe dhe hapësirë sportive, edhe pse afati për pagesë ka kalu moti, por iniciatorët e organizatës kanë gjet mirëkuptim te pronari, ku sipas informatave që kemi, organizata veçse po sheh mundësinë e bashkëpunimit me Sharrcemin, ku ata diku deri në 49 mijë euro me mujt me e mbështet organizatën, ku fillimisht do të funksionalizohet si hapësirë, me mundësi zhvillimi të aktiviteteve të ndryshme, por që akoma si proces është duke u punu në atë drejtim, e mandej mbetet vetëme dhe një pjesë e vogël, por që sivjet nuk mundemi em fillu me ndërtimin e shkollës, çerdhes dhe fushës sportive;
- pastrimi përroit përveç si kërkesë e banorëve, ka qenë edhe synim i joni për shkak të sigurisë, mirëpo nuk kemi mundur me gjet operator dhe me procedura të shpejta, por që dueht përmes prokurimit dhe kjo zgjat shumë , pra kjo ma shumë është çështje procedurale, pro që do ta kemi parasysh;
- te çështja e pengesave veçse e diskutum, por edhe te fabrika e suxhukut, ku pengesa ka qenë por e kanë hjek, gjithsesi duhet intervenu për rivendosjen e pengesës aty;
- qëllimi i trajtimit të pjesës para asajs hitores u bo që me u hjek ajo pjesa e vrazhdë edhe me u pengu që fëmijët me u rreziku aty, edhe pse aty mundet ndoshta me u vendos naj mur mbrojtës e mandej me u vendos naj kënd i lojërave, por që mbetet me u diskutu;
- lidhur me sigurinë nga emigrantët, ne vazhdimisht i diskutojmë si tema në KKSB ku janë pjesëmarrës edhe policia edhe vija e gjelbërt, ku ata presin informacion nga qytetarër lidhur em emigrantët ilegalë, dhe sa më shumë bashkëpunim me qytetarëve dhe institucioneve përkatëse,

atyre emigrantëve iu ofrohet edhe trajtim më i mirë, ku sa e dimë ekzistojnë qendrat strehimore për ta dhe ka organizata dhe institucione tjera që merren me ta, për t'i integruar; -lidhur me subvencionimin, ju njoftoj se të hyrat vetanake rriten me bartjen e bxuhetit nga viti aktual në vitin pasues, dhe subvencionimi bëhet totalisht nga të hyrat e komunës, dhe komuna ka mbështetur të rinjtë duke e arritur numrine bursistëve 50 studentë gjithsesj, poashtu komuna mbështet studentë jashtë burse por me kushte të rënda, poashtu OJQ të ndryshme me mjete monetare ose siç i keni parë edhe me rehabilitim në Banjë të Killokotit oër pensioenrët, handikos apo kategori tjera, e gjithashtu prej dy vitesh radhazi, komuna mbështet start-up dhe bizneset egzistuese që janë inovative, normalisht ne do të shohim mundësinë e rritjes së subvencioneve.

Visar Hasallari: Edhe një kërkesë e kam, e di që nuk është në kompetencë të Komunës, por e dimë që ju si komunë keni arrit që menaxhimin e ujit me e vendos mbi Bifurkacionin, dhe Lagja e Re e rrjetin nga Gllloboçica dhe kërkoj që me u shqyrtu mundësia për shtimin e kapaciteteve të ujit.

Mehmet Ballazhi: Thatësirat sivjet janë shumë të theksme, dhe niveli i ujit ka ra nga 7 litra në 3 litra, e poashtu ka ndiku edhe humbjet në rrjet se spo du me i qujt keqpërdorime. Ne kemi hulumtu për burime të reja dhe ato nuk munden me u bo për shpejt e shpejt, dhe ne kemi shqyrtu edhe një burim në pjesën e Jazhincë - Gllloboçicë, dhe nëse do të ishte vullneti i banorëve, mirëpo sa e kemi pa nuk ekziston, dhe poashtu ake dhe procedura tjera që duheshin ndjekë shkak se përfshihen sy shtetet, Kosovë e Maqedoni. Kemi bërë hulumtim në Shtrazë, dhe ka ujëra sipërfaqësorë, mirëpo ne nuk guxojmë ato ujëra me i vendos në rrjet pa e bo përpunimin e tyre dhe me bo fabrikë aty, nuk janë mundësitë. Për moment jemi duke hulumtu mundësinë për me e bo një projekt për të ardhmen me e bo një fabrikë të përpunimit të ujit përmes Rekës së Kotlinës dhe Shtrazhës, e që do të jetë furnizim 100 vjeçar se s'mundemi me thanë i përhershëm. Janë disa alternativa që po mundohemi me i gjetë por këto nuk bëhen shpejt e as sot për sot.

Halim Ballazhi: E kuptum që rryma nuk hyn në kompetenca të komunës, por kisha kërku që me u vendos shtylla prej te vorrezat e dëshmorëve në Puset e Nikës e deri nalt, sepse shtyllat dhe telat e rrymës janë krejt për toke. Si dhe kam një kërkesë që me u fut në buxhet me u maru rruga e Tanasit që i thojmë te kodër vorre anej kah Rezhanca e me u lidh me Puset e Nikës me Gorancë.

Mehmet Ballazhi: Projektin e zgjerimit apo rihapjes së rrugëve ne e kemi veçse në projekt, dhe e kemi parasysh edhe këtë rrugë, ku kjo është kërku edhe në dëgjimin në Gorancë.

Sadat Hasallari: Kisha propozu që rruga e Hasallarve atje nalt me u lidh me Gorancë e Krenenik, si dhe te rr."Veteranët e UÇK-së" atje kah aga Ismet me pa mundësinë me u vendos mur mbrojtës. Si dhe me mujt që aty te pllaci me u vendos një shenjë për orientim të rrugës kah Tetova, se shpesh veturat që dojnë me shku në Tetove, kalojnë përmes Lagjes së Re, e pse me shku anje kur rruga tjetër është am e drejtë për ta.


Mehmet Ballazhi: Lidhur em rrugët, të njëjtin status edhe e ka edhe kjo si tek rruga tjetër që u kërku me u hap, edhe kjo që e kërkon është pak a shumë njëjtë, e për murin mbrojtës duhet shqyrtu.

Endrit Rexhallari: Unë e kam një ankesë për ato sirianët që po rrijnë kah xhamia, edhe lojnë shumë papastërti, ku ne vet i pastrojmë mbeturinat që ata i lojnë.

Mehmet Ballazhi: Ne do t'i marrim të gjitha rekomandimet tuaja, do t'i shënojmë dhe do t'i shqyrtojmë. A ka edhe dikush diçka me shtu apo me plotësu? Nëse nuk ka, e shpall të mbyllur dëgjimin buxhetor.

Mbledhja përfundoi në ora 19:55.

Procesmbajtësja
Liridona Ballazhi



Kryetari i Komunës
Mehmet Ballazhi

143

